

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-093/13

**Prishtinë/Priština,
12 Shkurt 2014**

Në çështjen juridike të

B. M.
Mali i Zi

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

kundër

H. H.
Prizren/Prizren

Pala përgjegjëse në kërkesë/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Willem Brower dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/184/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrin 28538), të datës 14 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 shkurt 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B. M. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/184/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28538), e datës 14 dhjetor 2012.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/184/2012, sa i përket kërkesës në lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA28538.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 mars 2007, paraqitësja e kërkesës B. M., në cilësinë e anëtares së familjes të V. M., paraqiti një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e objekteve komerciale që ndodhen në rrugën “Cara Dusana” nr.60 në Prizren. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA 28538. Së bashku me kërkesën, ajo paraqiti, *inter alia*, kopjen e kontratës së qirasë Nr. 265 të datës 19 shkurt 1998, të lidhur ndërmjet “Shoqërisë Aksionare Liria” dhe “Kompanisë Bela” për periudhën duke filluar nga 19 shkurti 1998 deri më 19 shkurt 1999, si dhe kopjen e procesverbalit të marrëveshjes jashtëgjyqësore (pa numër dhe datë) të lidhur ndërmjet tyre. Këto dokumente janë verifikuar negativisht nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP).
2. AKP beri njoftimin e kërkesës më 31 korrik 2007. Pronën kishte qenë duke e përdorur H. H. i cili pohoi se e kishte blerë pronën me tender nëpërmjet procesit të privatizimit. Ai paraqiti njoftimin e pjesëmarrjes duke pretenduar të drejtën e pronësisë dhe të shfrytëzimit. Ai dorëzoi kopjen e “Deklaratës së Transferit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit” Nr. 1112 e datës 30 prill 2008, “duke vepruar për dhe në emër të Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) “Liria” Lidhur me Transferin e Pasurive dhe Obligimeve të caktuara të NSH “Liria” të Shitoret Newco Liria sheshi i Lidhjes së Prizrenit Sh.P.K.”, dhe “Marrëveshjen për Shitjen e aksioneve të zakonshme në Shitoret Newco Liria sheshi i Lidhjes së Prizrenit Sh.P.K.”, Nr. 113/2008 e datës 30 prill 2008, “nga dhe ndërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në cilësinë e Administruesit për dhe në emër të NSH Liria dhe N.T. Breu Petrol SH.P.K.”. Dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse në kërkesë janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
3. Gjatë procedurës, paraqitësja e kërkesës ndryshoi kërkesën e saj fillestare duke cekur se i biri i saj, i cili është pronari i kompanisë Bela, kishte investuar në transformimin e pronës së kërkuar. Ajo pranoi se prona i ishte shitur një pale të tretë gjatë procesit të privatizimit. Në vend të kësaj, ajo kërkoi kompensimin në shumën prej 66.427 Eurove që nga 1 marsi i vitit 2000.
4. KKPK, me Vendimin e vet të datës 14 dhjetor 2012, hodhi poshtë kërkesën në mungesë të juridiksionit.

5. Vendimi i KKKP-së iu dorëzua paraqitëses së kërkesës më 26 mars 2013. Ajo paraqiti ankesë duke e kundërshtuar vendimin më 2 prill 2013

6. Ankesa iu dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë/ palës përgjegjëse në ankesë më 1 korrik 2013. Ai nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës.

Arsyetime ligjor

Pranueshmëria e ankesës

7. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të përcaktuar në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Juridiksioni

8. Pala ankuese pohon se KKKP ka juridiksion të shqyrtojë një kërkesë të tillë. Për të ardhur në përfundimin se KKKP ka juridiksion mbi një kërkesë; (1) kërkesa duhet të ndërlidhet me pronën e paluajtshme private; (2) zgjidhja e kërkuar në kërkesë duhet të jetë njohja e së drejtës pronësore apo e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private dhe/ose ri-posedimi i saj; (3) humbja e pronës duhet të rrjedh nga rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejt me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Asnjë nga këto kushte nuk janë plotësuar në rastin konkret.

Sa i përket kërkesës fillestare me të cilën kërkohej ri-posedimi i objekteve biznesore:

9. Fillimisht, nëse pala ankuese kishte lidhur ndonjëherë një kontratë qiraje të tillë me NSh Liria dhe e ka vazhduar edhe pas 19 shkurtit 1999, kërkesa e tillë nuk bie nën juridiksionin e KKKP-së. Letra e saj drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronës tregon se, edhe sipas pozitës së palës ankuese, humbja e posedimit të objektit të marrë me qira nuk rrjedh nga rrethanat e konfliktit të armatosur pasi që ajo pohon se ka vazhduar të shfrytëzojë objektin qetësisht edhe pas përfundimit të konfliktit.

10. Së dyti, pavarësisht faktit se pala ankuese përkufizon statusin e Ndërmarrjes “Liria” si Shoqëri Aksionare, dokumentet në shkresat e lëndës zbulojnë se Ndërmarrja “Liria” nuk është kompani private.

11. “Liria” ka qenë ndërmarrje shoqërore që është transformuar në “Shitoret Newco Liria Sheshi i Lidhjes se Prizrenit Sh.P.K” nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Përfundimisht, sendet e paluajtshme të lartcekura i janë shitur poseduesit të tanishëm nëpërmjet procesit të privatizimit. Objektet nuk kanë qenë pronë e paluajtshme private, por pasuri e paluajtshme të një ndërmarrje shoqërore. Sa i përket paraqitjes së kërkesës

në AKP, kërkesat, përfshirë kërkesat kreditore apo kërkesat për pronësi, të paraqitura kundër një Ndërmarrje apo Korporatë, ose kërkesat që kanë të bëjnë me njohjen e së drejtës, titullit, apo interesit në një pronë që është në posedim apo kontroll të një Ndërmarrjeje apo Korporate, që ka qenë apo është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, të cilat kërkesa janë paraqitur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë është apo ka qenë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë, këto kërkesa bien në juridiksionin e Dhomës e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas nenit 4.1.c dhe 4.1.d të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13. Për më tepër, Ligji për Dhomën e Posaçme nr. 04/L-033, që zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4, rregullon juridiksionin e Dhomës në mënyrën e njëjtë. Në nenin 4.1.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme përcaktohet se kërkesa që pretendon një të drejtë, titull apo interes në lidhje me çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia e Privatizimit të Kosovës apo Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ka apo ka shpallur autoritetin administrativ është nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme. KKPK nuk ka juridiksion të shqyrtojë kërkesat që pretendojnë të drejtën pronësore mbi apo ri-posedimin e një pasurie të një ndërmarrjeje shoqërore.

Sa i përket kërkesës së ndryshuar me të cilën kërkohet kompensimi i investimeve që pretendohet se janë bërë:

12. Në kërkesën e ndryshuar, pala ankuese ka kërkuar pagesën e 66.427,00 Eurove që nga 1 marsi 2000. Një kërkesë kreditore me të cilën kërkohet kompensim për investimet e bëra në një send të paluajtshëm të një ndërmarrjeje shoqërore para privatizimit të saj nuk bie nën juridiksionin e KKPK-së por të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

13. Duke supozuar se pala ankuese pohon dhe synon të dëshmojë se “Liria” nuk është ndërmarrje shoqërore por kompani private, kërkesa për kompensim të investimeve të bëra nuk do të ishte nën juridiksionin e KKPK-së por të gjykatës së rregullt. KKPK nuk mund të merret me kërkesat kreditore sa i përket pronës private sipas neneve 3.1a dhe 3.1.b të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

14. Gjykata Supreme konsideron se KKPK nuk ka juridiksion mbi një kërkesë që ka të bëjë me qiranë e një ndërmarrjeje shoqërore apo mbi një kërkesë kreditore gjoja të bërë në objektet e ndërmarrjes shoqërore. As kërkesa fillestare e as ajo e ndryshuara nuk ndërlidhen me të drejtën pronësore apo të shfrytëzimit sa i përket pronës së paluajtshme private. Humbja e posedimit gjithashtu nuk rrjedh nga rrethanat që përfshijnë apo ndërlidhen me konfliktin e armatosur. Prandaj, ankesa e palës ankuese refuzohet si e pabazuar sipas nenit 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079

Këshillë ligjore

15. Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it